



Udhëzues për aplikimin online në raundin e dytë të pranimeve
Formulari A3
(Në mjediset e shkollave të autorizuara nga DAR/ZA –të)

Viti Akademik 2014-2015


1. Për të kryer aplikimin online duhet të shkoni tek linku: <http://matura.akp.gov.al>
2. Te faqja e hapur do të keni pamjen e mëposhtme:



3. Këtu duhet të klikoni te butoni : “**Identifikohu**” dhe do t’ju shfaqet pamja e mëposhtme:




4. Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen ID (UserName) dhe fjalëkalimi (Password) që ju kemi dërguar bashkëngjitur këtij udhëzuesi. Shikoni shembullin e mëposhtëm:




Përfaqësuesi i DAR/Za-së do të logohet në të gjitha kompjuterat e laboratorit /laboratorëve me të njëjtën ID dhe Fjalëkalim duke i lejuar maturanët të aplikojnë njëri pas tjetrit.

5. Klikoni tek butoni  dhe do t'ju shfaqet dritarja e mëposhtme:



6. Klikoni tek butoni A3 në pjesën e sipërme majtas të dritares dhe do t'ju shfaqet dritarja e mëposhtme:



7. Në fushat Emri, Mbiemri do të shënohet emri dhe mbiemri i maturantit/kandidatit i cili duhet të përputhet me emrin që keni në bazën e të dhënave që na është dërguar. Në rast të kundërt sistemi nuk mund ta identifikojë dot. Në raste të tilla bëhet kërkimi me anë të emrit të shkollës i cili përzgjidhet nga Drop Down list përkatëse.

Perdoruesi: PERDORUESI | Dil | Ndrysho fjalekalim

Plotëso A3 (për Operatorët)

Plotëso A3 (për Operatorët)

Emri
ARJOLA

Mbiemri
ÇEKREZI

Shkolla e Mesme

Kërko

8. Shtypni butonin **Kërko** dhe shfaqet dritarja e mëposhtme:

Perdoruesi: PERDORUESI | Dil | Ndrysho fjalekalim

Plotëso A3 (për Operatorët)

Plotëso A3 (për Operatorët)

Emri
ARJOLA

Mbiemri
ÇEKREZI

Shkolla e Mesme

Kërko


Zgjidh	Emri	Atesia	Mbiemri	DataLindja	VendLindja	Gjinia	Profili Shkolles	Shkolla
	ARJOLA	AVNI	ÇEKREZI	17/02/1992	BATHES	Femër	GJIMNAZI DREJTIMI I PËRGJITHSHËM	ANASTAS ÇAKALLI


9. Klikoni mbi butonin **Zgjidh**. Sipas rasteve ju shfaqen dritaret e mëposhtme:

a) Rasti i parë

Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, dhe është i pa regjistruar, pra nuk ka dorëzuar dokumentat pranë sekretarisë së fakultetit, ku është shpallur fitues.

Maturanti do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë me preferencat e përzgjedhura në formularin A2.

Pasi të klikoni në butonin  ju shfaqet mesazhi **Veprimi u krye me sukses**



Kujdes: Nëse klikoni mbi butonin e sipërm “Konfirmo pjesëmarrjen në garë me A2”, nuk mund të anuloni veprimin më pas.


Për të lejuar aplikimin e një maturantit tjetër të radhës klikoni tek butoni A3 në pjesën e sipërme, majtas të dritares.

Më poshtë po paraqesim dhe raste të tjera të sipas statusit të maturantit që aplikon. (Shih udhëzimin e MAS për pranimet në raundin e dytë, Formulari A3)

b) Rasti i dytë

Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, jo në preferencën e parë. Në regjistrimin online ka konfirmuar vazhdimin e garës dhe ka dorëzuar dokumentet pranë sekretarisë së fakultetit.

Maturanti do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë me preferencat e përzgjedhura në formularin A2.




Kujdes: Nëse klikoni mbi butonin e sipërm “konfirmo pjesmarrjen në garë me A2”, nuk mund të anuloni veprimin më pas. Nëse shpalleni fitues në preference më të lartë se ajo në të cilën jeni regjistruar me dorëzim dokumentash në sekretari në raundin e parë, sistemi ju cregjistron automatikisht nga preferenca në të cilën jeni regjistruar në raundin e parë dhe ju do të paraqiteni për tu regjistruar në preferencën ku jeni shpallur fitues në këtë raund(raundi i dytë).

c) Rasti i tretë

Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2 në preferencën e parë dhe është regjistruar në këtë program duke kryer dorëzimin e dokumenteve në sekretarinë mësimore të fakultetit.

Maturanti nuk do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë.



c) Rasti i katërt

Maturanti i shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, por jo në preferencën e parë, i cili në regjistrimin online ka konfirmuar ndërprejten e garës duke klikuar butonin: “Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar” dhe ndërkohë ka dorëzuar dokumentet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit. Maturanti nuk do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë.



d) Rasti i pestë

Maturanti nuk ka plotësuar formulari A2 në raundin e parë. Maturanti do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë duke plotësuar formularin A3. Dritarja e mëposhtme shfaqet në ekran, ku do të përzgjedhë programet e studimit në të cilat do të konkurrojnë në të njëjtën mënyrë si tek formulari A2 (Shih paketën informuese për plotësimin e formularit A2 në faqen zyrtare të MAS dhe AKP www.arsimi.gov.al dhe www.akp.gov.al). Më poshtë po japim një shembull ilustrues.

Formulari A3

Emri RODRIK	Vendlindja BERDICE, SHKODËR	Nota Mesatare	5.39
Atesia SALVATOR	Shkolla e Mesme (300) FREDERIK GJONI, SHKODËR	LETËRSI 2012	5.63
Mbiemri PIETRUSHI	Profili GJIMNAZI 2012	MATEMATIKË 2012	6.02
Gjinia Mashkull		Psikologji	5.60
Data lindja 11/03/1993		Qytetari	7.06
		Gjeografi	5.72

Program e Studimi dhe Piket Minimale nga 3 Vitet e Kalluara:

-- Zgjidh --

[+] Perzgjidhe Programin

Ju nuk keni perzgjedhur asnje program studimi akoma.

Kodi i Mbikqyresit

Dergoje Formularin

- Në pjesën e sipërme maturantit i shfaqen të gjitha gjeneralitetet si dhe pikët/nota mesatare e shkollës së mesme si dhe notat e marra gjatë provimeve të Maturës Shtetërore.
- Poshtë të dhënave personale të maturantit është një Drop Down List e cila i jep mundësinë atij që të përzgjedhë programet e studimit që ofrohen në raundin e dytë nga IALP-të.
- Pas përzgjedhjes, më poshtë, shfaqen pikët që maturanti grumbullon në këtë program studimi dhe pikët e fituesit të fundit në fazën e dytë të aplikimit me formularin A2. Duke i krahasuar pikët personale të grumbulluara me pikët e fituesit të fundit, maturanti merr vendim që të përzgjedhë ose jo atë program studimi. Për ta përzgjedhur një program studimi ai duhet të klikojë mbi butonin “Përzgjidhe Programin”.

Sistemi informatik nuk të lejon që të përzgjidhen më shumë se 10 preferenca, por lejon që të fshihet ndonjëra prej tyre si dhe të rirënditen ato. Nëse maturanti do të heqë një program të caktuar studimi ai duhet të klikojmë tek butoni “Hiqe” ndërsa për t’i rirënditur në kutizat anësore duhet të shtypë renditjen e re te propozuar dhe më pas të klikojë mbi butonin poshtë “Ruaj Renditjen”.

(Kujdes! Gjatë vendosjes së renditjes së re nuk duhet të kemi përsëritje numrash)

- Mozilla Firefox
 ry Bookmarks Tools Help
 bz/aplikimet/Protected/DataEntry/A2Form/Default.aspx?StudentID=0001A9CFD3664C59BAA8D313EDC8F9B1
 Search the web (Babylon)

Menu
 A3

Formulari A3

Emri RODRIK	Vendlindja BERCICE, SHKODER	Nota Mesatare	5.39
Atesia SALVATOR	Shkolla e Mesme (300) FREDERIK GJONI, SHKODER	LETËRSI 2012	5.63
Mbiemri PJETRUSHI	Profili GJIMNAZI 2012	MATEMATIKË 2012	6.02
Gjinia Mashkull		Psikologji	5.60
Datelindja 11/03/1993		Qytetari	7.06
		Gjeografi	5.72

Programe Studimi dhe Piket Minimale nga 3 Vitet e Kaluara:
 161 - UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS "Eqrem Çabej" - Mësuesi për Arsimin Fillor

[+] Perzgjidhe Programin

Preferenca	Programi i Studimit	Kodi	Universiteti
1 Hiqe	Inzhinieri Gjeoinformatikë	088	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
2 Hiqe	Përpunim Druri	067	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
3 Hiqe	Gjuhë Italiane	186	UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"
4 Hiqe	Shkenca Kompjuterike	195	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"
5 Hiqe	Mësuesi për Arsimin Fillor	161	UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS "Eqrem Çabej"

Ruaj Renditjen

Kodi i Mbikqyrësit

Dërgoje Formularin

Vini re: Nuk është e nevojshme të shkruani kodin e mbikëqyrësit

- Theksojmë edhe njëherë se për suksesin e aplikimit me formularin A3 janë të rëndësishme jo vetëm llojet e programeve të studimit të përzgjedhura, por dhe renditja e tyre.
- Më pas klikoni mbi butonin “Dërgoje Formularin” dhe shfaqet dritarja e mëposhtme që ju jep mundësinë e printimit të formularit A3.

